

Drejtuar: Të gjitha klubeve

Lënda : Njoftim për ndryshimet në Rregulloren Zyrtare të Basketbollit 2010

Dt: 4 Shtator,2010

Më 1 tetor 2010, hyjnë në fuqi një sërë ndryshimesh zyrtare në rregulloren e FIBA . Disa prej këtyre ndryshimeve janë aprovuar në 2008, por zbatimi i tyre,do të bëhej dy vitet e ardhshme, në mënyrë që federatat të kishin kohë mjaftueshëm për të përgatitur fushat me vijëzimet përkatëse. Disa prej këtyrë ndryshimeve janë më pak të rëndësishme, por që luajnë një funksion të rëndësishëm në tërësinë e të gjithë rregullores.Përmbledhja e të gjithë ndryshimeve është bërë konform neneve dhe rregullave respektive siç janë paraqitur në Rregulloren Zyrtare të FIBA për 2010, të cilat mund t'i gjeni edhe në faqen zyrtare të internetit të FIBA www.fiba.com.

Art.. 2.4.3

VIJAT E GJUAJTJEVE TE LIRA, ZONAT E VECANTA DHE POZICIONET PER LUFTEN NE TABELLE (REBAUNDET) GJATE GJUAJTJEVE TE LIRA

Ndryshimi kryesor aprovuar në 2008, për tu zbatuar në vitin 2010, është ai përmasave dhe formës së zonës së vecante. Trapezi unik për FIBA, funksional për shumë vite, do të zëvendësohet me një zonë të kufizuar në formën e drejtkëndëshit, të ngjashëm me atë TE fushave në NBA. Një ilustrim të tij do ta gjeni në Art. 2.4.7 të rregullores zyrtare të basketbollit. Edhe pse forma e zonës së vecante ndryshon, interpretimet mbeten njësoj.

Art. 2.4.4

ZONA E TRE PIKESHIT

Gjysem rrethi i gjuajtjeve nga loja per tre pike duhet të zgjatet në një rreze prej 6.75 m, matur kjo nga një pikë e caktuar ne fushe poshte qëndres se koshit. Ilustrimet specifike të harkut mund t'i gjeni në diagramën 1 të Rregullores Zyrtare të Basketbollit 2010. Edhe pse hapsira e fushes per tre pike është zvogluar, rregullat përkatëse dhe interpretimet nuk kanë ndryshuar.

Art. 2.4.6/17.2.4

VIJAT E RIVENIES; RIVENIA

Një ndryshim tjetër rrënjësor për tu implementuar në 2010 është rregulli qe zbatohet gjatë pushimit te mare në dy minutat e fundit të periodes së 4 ose te cdo periudhe shtese, kërkuar nga skuadra qe ka te drejten e zoterimit te topit per rivënie nga vijat kufizuese. Më parë rivënia ekzekutohej në zgjatim te vijes se mesit, perballe tavolinës së gjyqtarisë. Me rregullat e 2010, janë shtuar dy vijëzime të reja te fushes. Secila vijë është perpendikulare më vijën anësore nga ana e jashtme e fushes së lojës drejt majes se harkut te 3 pikëshit.

Rivënia e sipërpërmendur e cila me pare realizohej nga zgjatimi vijes se mesit, tani do të administrohet nga vija perkatëse e rivenies ne pjesen e perparme te fushes se skuadres qe ka te drejten e rivenies. (Pika 17.2.4)

Art. 2.4.7

ZONA E GJYSEM RRETHIT PA NDESHJE

Një tjetër ndryshim i madh, aprovuar në 2008 dhe për tu zbatuar përsëri në 2010, është gjysmëqarku pa ndeshje. Ne fushe do te vizatohen gjysmërrathët , secili me një reze 1.25 m dhe me qendren poshte qendres se secilit kosh. Rezja e secilit reth prej 1,25m do te matet nga ana e brëndshme e gjysmërrëthit. Sa më sipër këto zona mund ti shihni në Art. 33.10, ilustruar më vonë në përmbledhjen e kësaj rregulloreje.

Art.8.6/9.1/9.2

MBARIMI I NJE INTERVALI TE NDESHJES;/ FILLIMI DHE MBARIMI I NJE PERIODE OSE I NDESHJES

Sipas rregullores se 2010, perioda e pare fillon dhe intervali i ndeshjes mbaron kur topi le duart e gjyqtarit te pare ne topin e hedhur (Art. 8.6/9.1)

Per te gjitha periodat e tjera dhe kohet shtese, perioda fillon kur topi eshte ne dispozicion te lojtarit qe ben rivenien (Art. 8.6/9.2).

Art. 10.2

TOPI HYN NE LOJE

Gjatë një topi te hedhur, topi hyn ne loje kur ai le duart e gjyqtarit te pare gjatë hedhjes së tij.

Art. 16.2.5

GJUAJTJA E BERE NE 0.3 SEKONDAT E FUNDIT TE NJE PERIODE

Per nje lojtar qe zoteron topin ne fushe direkt nga (a) pas nje rivenie ne loje ose (b) nga lufta ne tabele pas gjuajtjes se fundit apo te vetme te lire dhe gjuan menjehere, ne oren e lojes duhet te kete jo me pak se tre te dhjetat e sekondes qe gjuajtja të jete e vlefshme. Nëse ka mbetur më pak se 0.3 e sekondës kohë, mund të realizohet një gjuatje nga loja vetem me prekje ose zhytje.

Art. 20.2.3

HUMBJA E NDESHJES AFORFE

Nëse një skuadër humb ndeshjen aforfe dy herë gjatë një **turneu** , ajo duhet të skualifikohet dhe rezultatet e mbledhura të asaj skuadre anulohen.

Art. 28.1.1

TETË SEKONDAT

Kur nje rivenie ne loje behet ne pjesen e prapme te fushes, numerimi 8 sekondave do te filloje (ose rifilloje), kur topi prek ndonje lojtar ne fushe (mbrojtës ose sulmues) ne pjesen e prapme, me kusht qe skuadra qe ben rivenien mbetet ne zoterim te topit.

Art. 28.1.2

TETË SEKONDA

Permbajtja e Art. 28 qe ka te beje me kalimin e topit nga pjesa e prapme ne ate te perparme eshte riformeluar dhe eshte bere nje ndryshim i rregullit.

Ndryshimi eshte bere ne Art. 28.1 .2, pika 2: topi shkon ne pjesen e perparme te fushes se skuadres kur ai prek ose preket sipar rregullit nga nje lojtar sulmues qe ka te dyja kembet ne kontakt me pjesen e perparme.

Ashtu si edhe ne rregulloren e mepareshme, topi shkon ne pjesen e perparme kur:

1. Ai prek ose preket rregullisht nga nje lojtar mbrojtës qe ka ndonje pjese te trupit ne kontakt me pjesen e prapme te fushes.
2. Pa qene ne kontroll te ndonje lojtari, ai prek pjesen e perparme te fushes.
3. Ai prek ndonje gjyqtar qe ka ndonje pjese te trupit te tij ne pjesen e perparme.
4. Gjate driblimit nga nga pjesa e prapme ne ate te perparme. Te dyja kembet e lojtarit dhe topi jane ne kontakt me pjesen e perparme te fushes.

Art. 29.1.1

NJEZETEKATER SEKONDA

Gjatë një rivënien, ora e 24 sekondëshit duhet të fillojë kur topi prek ose preket nga një lojtar (mbrojtës apo sulmues) në fushën e lojës, me kusht qe skuadra e lojtarit që ka bërë rivënien mbetet në kontroll të topit.

Art. 29.2.1

NJEZETEKATER SEKONDA

Pika 29.1 ka përbërë një vlerësim domethënës që përcakton një ndryshim themelor të këtij rregulli.

Nëse loja ndërpritet për shkak të ndonjë gabimi ose shkeljeje (jo për arsye të daljes së topit jashtë) të shkaktuar nga skuadra që nuk zotëron topin ose loja ndalon për arsye që ka të bëjë me skuadrën që nuk zotëron topin apo për ndonjë arsye që nuk ka të bëjë me skuadrat, rivënia e topit do t'i jepet ekipit që kishte topin në zotërim.

Në rast se rivënia duhet të realizohet në pjesën e pasme të fushës, ora e 24 sekondëshit duhet të rivendoset në 24 sekonda. Nëse rivënia duhet të bëhet në pjesën e përparme të fushës dhe në display kanë mbetur 14 sek apo më shumë, që nga koha e ndërprerjes së lojës, display i 24 sekondëshit nuk duhet ndryshuar por do të vazhdojë aty ku ka ndaluar.

Në rast se rivënia në lojë do të bëhet në pjesën e përparme të fushës dhe në display të 24 sekondëshit kanë mbetur 13 sek apo më pak në kohën e ndalimit të lojës, atëherë në display duhet të vendosen 14 sek.

Art.33.10

GJYSEM RRATHET PA NDESHJE

Ne depërtimin gjatë lojës në zonën gjysem rrethore pa ndeshje, lojtari sulmues nëse është në ajër dhe bie mbi një kundërshtar që është brenda zonës gjysemrrethore pa ndeshje nuk ngarkohet me gabim në sulm me kusht që (a) lojtari sulmues është në ajër kur zotëron topin (b) lojtari mbrojtës i ka të dyja këmbet brenda zonës pa ndeshje (c) lojtari sulmues nuk përdor duart, krahet, këmbet ose trupin padrejtësisht.

Filozofia e aplikuar për rastet e sipërpërmendura, është e zgjeruar në Rregulloren Zyrtare të FIBA 2010, Interpretimet Zyrtare që i gjeni në webin www.fiba.com si edhe në web e FSHB.

Art 46.12

GJYQTARI I PARE: DETYRAT DHE TE DREJTAT

Gjyqtari i pare është autorizuar ,konform rregullores së mëparshme ,të përdorë pajisjet teknike për të vendosur nëse gjuajtja e fundit shënuar në fundin e cdo periode ose periode shtese eshte bere brenda kohes se lojes..

Ky autorizim është zgjeruar paksa në rregulloren e re të 2010-ës përfshirë përdorimin e pajisjeve të tilla në fund të secilës periodë apo periodave shtesë që përcaktojnë nëse koshi i realizuar është 2 apo 3 pikësh. Ky autorizim parashikohet në shtojcën C, Procedura e Protestimit, seksioni C4.

Art. 50

DETYRAT E MBAJTESIT TE 24 SEKONDESHIT

Në lidhje me ndryshimet e Art. 29, detyrat e mbajtesit te 24 sekondëshit janë zgjeruar dhe rishkruar, por ndryshimi kryesor shtesë, është ai lidhur me rivëniet në pjesën e përparme të fushës.

Sinjalet zyrtare: (Sinjali nr 9) ky sinjal i përdorur për rivendosur kohën 24 sekonda do të përdoret tashmë edhe për vendosjen e kohës 14 sekonda kur është e nevojshme.

Njoftohen të gjithë trainerët dhe gjyqtarët e tavolinave se në dt. 24 Shtator 2010 ora 17:00 pranë , Agjensisë së Shërbimit të Sporteve tek Stadiumi “Qemal Stafa” –Salla e mbledhjeve,do të organizohet seminari me temë “Ndryshimet e Rregullores Zyrtare të FIBA 2010”.

Jeni të lutur të merrni pjesë në këtë takim, pasi është i një rëndësie të veçantë.

Me respekt

Korab Llazani

Sekretar I Përgjithshëm